



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË DURRËS

Nr. 18 Prot.

Durrës, më 27.05.2019

**N J O F T I M PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË KONKURIMIT PËR
EMËRIMIN NË POZICIONIN E PUNËS KOORDINATOR**

Bazuar në ligjin nr 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe urdhërit nr 27 date 21.02.2019 të Prokurorit të Përgjithshëm për “Strukturën organike të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës”, me qëllim plotësimin e vendeve vakante që ekzistojnë në strukturën e institucionit në pozicionin 1 (nje) Koordinator, Prokuroria Prane Gjykates se Shkalles se Pare Durrës:

N J O F T O N

1. Fillimin e procedurës për konkurim të hapur të kandidatëve për pozicionin Koordinator, pranë Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.

2. Referuar neneve 68,74,75,76, te ligjit nr 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, kandidatët e interesuar për konkurim, përveç kushteve të përgjithshme për tu pranuar në shërbimin civil, duhet të plotësojnë dhe kriteret të veçanta si me poshte: Arsimi, trajnimi dhe eksperiencia:

Kriteret e nevojshme.

Të jetë shtetas shqiptar.

Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.

Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo kundërvajtjeje penale me dashje, ose ndaj tij të mos ketë një hetim penal në proces;

Të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e konkurimit.

Të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për psikologji, sociologji, ose fusha të tjera të ngjashme.

Të ketë aftësi për të krijuar marrëdhënie pune efektive me stafin e prokurorisë, ofruesit e shërbimeve, që operojnë në komunitet, viktimat dhe publikun.

Të ketë aftësi për të ndërvepruar në mënyrë efektive dhe me takt me viktimat emocionalisht të shqetësuara. Të ruajë sekretin hetimor.

Të ruajë konfidencialitetin e informacionit të viktimës.

Të ketë integritet dhe cilësi të larta morale.

Të marrë pjesë në trajnime të vazhdueshme në lidhje me viktimat e krimit. Të ketë njohuri të mira kompjuterike të tilla si: Microsoft Word, Excel, Power Point, etj.

Kritere të preferuara, por jo të nevojshme:

Njohja e shërbimeve që u ofrohen viktimave të krimit nga ofrues të ndryshëm shtetërorë dhe jo qeveritarë.

Njohja e sistemit të drejtësisë penale dhe procedurave gjyqësore.

3.Kandidatët për pozicionin e lirë të punës “Koordinator” duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

- a.Kërkesë me shkrim,
- b.Kopje të dokumentit të identifikimit,
- c.Curriculum Vitae,
- d.Diplomë universitare të nivelit 3+2 dhe listë notash (të noterizuara).
- e.Dokument qe verteton praktiken profesionale.
- f.Dëshmi kualifikimi apo specializimesh (nëse ka),
- g.Vlerësime të punës nga punëdhënës të mëparshëm,
- h.Vërtetim për gjendjen gjyqësore, i.Raport mjeko-ligjor,
- j.Çertifikatë të gjuhës së huaj (nëse ka).
- k.Dëshmi kompjuteri.

4. Kërkesa sëbashku me dokumentacionin e kandidatit, të paraqitet brenda datës 11.06.2019 në K/Sekretarinë e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.

**KOMISIONI I PRANIMIT PËR PROÇEDURAT E PUNËSIMIT NE
PROKURORINË PRANË GJYKATES SË RRETHIT GJYQËSOR DURRES**